



Fatmir Krasniqi  
Modersmåslärare  
i albanska  
[fatmir.krasniqi@salem.se](mailto:fatmir.krasniqi@salem.se)

Barn- och utbildningsförvaltningen  
Salems kommun



Salems  
kommun

## **Gjuha amëtare dhe shumë gjuhë të tjera**

Flisni ndonjë gjuhë tjetër në shtëpi me fëmijët e juaj përveq suedishtës?

Në komunën e tonë keni mundësi të kërkonit, që fëmija i juaj të ushtroj gjuhën amëtare, që nga mosha parashkollore dhe në shkollën fillore të mësoi gjuhën amëtare, njësoj si lëndët tjera. Qellimi është, që nxënësit të flasin sa më shumë gjuhë dhe të kenë sa më shumë njohuri, për identitetin dhe kulturën kombëtare, gjë që iu ofrohët mundësia të krijohen si individ shumëgjuhësor dhe kompetent për identitet kulturor të dyfishtë.

Gjuha amëtare është lëndë në vete me planprogram mësimor.

### **Për ta mësuar gjuhën amëtare kërkohët:**

- . Njeri apo që të dy prindërit flasin një gjuhë tjetër, përveq suedishtës.
- . Që nxënësi përdor gjuhën, në jetën e përditëshme.
- . Nxënësi ka njohuri themelore, në gjuhën amëtare (nuk është fillestar).
- . Duhët të jenë së paku 5 nxënës në komunë, që kërkojnë të mësojnë gjuhën amëtare dhe të këtë mësues për atë gjuhë.

Mirëpo, këto rregulla nuk vlejné për ata që flasin një gjuhë nacionale- minoritare: Samisk, finlandisht, tornedal-finlandisht, jiddisch dhe romani chib dhe ata që janë të adaptuar.

### **Procesi mësimor**

Mësuesi i gjuhës amëtare, është i kualifikuar dhe ka të njëjtin nacionalitet, kulture dhe traditë me nxënësit. Gjithashtu ka njohuri të plota në gjuhën suedeze.

Mësimi mbahët në ato shkolla, ku është e përshtatshme të formohën grupe mësimore, në mënyrë që të jenë sa më homogjene, nxënësit të kenë njohuri të përafërta, që mësimi të jetë kualitativ. Ka raste, kur mësimi nuk mbahët në të njëjtën shkollë ku nxënësi vijon mësimin.

### **Në komunën e Salemit mësohën këto gjuhë:**

Shqip, arabisht, asyrisht, bengalisht, bosanisht, kroatisht, serbisht, anglisht, finlandisht, greqisht, frengjisht, kurdisht, kinezisht, holandisht, persisht, polonisht, rusisht, somalisht, spanjollisht, tajlandisht, tigrinjesht, qeqenjisht, gjermanisht dhe hungarisht.

## **Kërkesa**

Prindërit plotësojnë kërkesën për mësimin e gjuhës amëtare. Mësimi është fakultativ dhe falas. Plotëso formullarin dhe dërgoje të shefi/drejtori i qerdhës/shkolles ku fëmiu i juaj vijon mësimin.

Në komunën tonë, në shkollën "skogsängsskolan" kemi dy klasë, për nxënës të rinjë në Suedi: një për ciklin e ulët dhe një për ciklin e lartë. Në këto klasë, nxënësit mësojnë shumë lëndë mësimore, por më së shumti mësojnë gjuhën suedeze. Se sa kohë vazhdojnë mësimin, në këto klasë, varët nga vetë nxënësit se sa janë aktiv dhe sa kohë iu nevojitet për ta mësuar gjuhën. Zakonisht mësimi në këto klasë zgjatë 1- 2 vite, mandej kalojnë në klasët e rregullta.

## **Mësim plotësues**

Për nxënës të rinj në sued, të cilët kanë vështirësi në gjuhën suedeze, organizohët mësimi plotësues. Mësuesi i gjuhës ndihmon dhe sqaron mësimin në gjuhën amëtare.

Për mësim plotësues vendos shkolla.

Për informata , kontaktoni:

Anna Levén

Biträtande rektor,

Centrum för flerspråkighet

070-723 17 72

E: post: [anna.leven@salem.se](mailto:anna.leven@salem.se)